



Biseda me prindërit në kopshtin e fëmijëve

(Fletë udhëzuese për prindërit dhe personat edukues)

Kopshti i fëmijëve është që nga 1. Janari 2008 pjesë e shkollës fillore (Volksschule) dhe përbën fundamentin zyrtar të formimit shkollor. Përmes kantonalizimit vlej në parim të gjitha rregulloret e shkollës fillore edhe për kopshtin e fëmijëve. Këshilli arsimor ka shpallur më 1. Shtator 2008 urdhëresën e re mbi lëshimin e dëftesave të shkollës. (Zeugnisreglement / LS 412.121.31)

Për kopshtin e fëmijëve vlen në veçanti:

1. Në kopshtin e fëmijëve nuk lëshohen dëftesa. Në vend të dëftesës pasojnë biseda me personat përgjegjës për përmbushjen e detyrimit shkollor të fëmijës.
2. Në çdo vit të kopshtit të fëmijëve -së paku dy herë- mësuesi përgjegjës për kopshtin e fëmijëve zhvillon me prindërit ose personat edukues biseda mbi zhvillimin e nivelit mësimor të fëmijës. Bisedat zhvillohen atëherë, kur mësuesi i kopshtit dhe prindërit apo personat edukues i shikojnë si të nevojshme. Mësuesi i kopshtit të fëmijëve është përgjegjës për caktimin e termineve.
Prindërit mund të heqin dorë nga biseda e dytë, në marrëveshje me mësuesin e kopshtit të fëmijëve.
3. Prindërit apo personat edukues vërtetojnë me nënshkrimin e tyre, që biseda është zhvilluar, ose që heqin dorë për zhvillimin e një bisede të dytë.
4. Formularët përkatës ruhen në një dosje të posaçme. Këto u dorëzohen prindërve apo personave edukues në fund të nivelit të kopshtit.
5. Kopjet e formularëve arkivohen si dëshmi në drejtorinë e shkollës.